



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministra Pravde - Office of the Minister
of Justice

Nr. 358/2024
Datë: 10/10/2024

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ, Nr. 7, 01 mars 2019), në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 34, 18 nëntor 2022), dhe duke u bazuar në nenin 368 (paragrafi 2) të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118 dhe Ligjin Nr. 08/L-102, si dhe në përputhje me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores (QRK) - nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Drejtësisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Flamur Bogaj, përmbartues privat në Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë suspendohet nga ushtrimi i funksionit të përmbartuesit privat deri në një vendim të Komisionit Disiplinor.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me datë 10.10.2024, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika ka pranuar nga Telekom i Kosovës Sh.A, kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ndaj përmbartuesit privat z. Flamur Bogaj, i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, me pretendimin se me ndërmarjen e veprimeve përmbartimore nga ana e përmbartuesit privat në rastin përmbartimor P.nr. 415/2024, ka kryer shkelje disiplinore nga paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.4 të nenit 367 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore.

Më datë 10.10.2024, kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat Flamur Bogaj është proceduar në Komision Disiplinor në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Andaj, me qëllim që procedura disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. Bogaj të zhvillohet e pa penguar u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridik: Kundër këtij vendimi mund të ngritet konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Albulena HAXHIU
Ministër e Drejtësisë



Vendimi i dërgohet:

- Përmbaruesit privat z. Flamur Bogaj;
- Odës së Përmbaruesve Privat;
- Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë,
Profesione të Lira dhe Statistika;
- Arkivoit të Ministrisë së Drejtësisë.